

VENDIM
Nr. 362, datë 26.5.2022

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT ARSIMOR,
SHKENCOR, KULTUROR DHE RINOR NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT
TË IZRAELIT, PËR VITET 2022–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të bashkëpunimit arsimor, shkencor, kulturor dhe rinor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit, për vitet 2022–2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PROGRAM I BASHKËPUNIMIT ARSIMOR, SHKENCOR, KULTUROR, RINOR
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT, PËR VITET 2022–2025**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e shtetit të Izraelit (në vijim të referuara si “Palët”),

të udhëbequr nga dëshira e tyre për të forcuar marrëdhëniet e tyre miqësore dhe për të promovuar shkëmbime në sferat e kulturës, arsimit dhe shkencës;

bazuar në Marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për bashkëpunim në fushat e kulturës, arsimit dhe shkencës, të nënshkruar në nëntor 1993;

të dyja palët janë të bindura se ky Program bashkëpunimi do të kontribuojë në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre dhe rritjen e ndërgjegjësimit, veçanërisht tek të rinjtë, për historinë dhe kulturën e popujve të të dyja vendeve dhe bien dakord të promovojnë bashkëpunimin, në mënyrë që të përmirësojnë dhe të forcojnë mirëkuptimin e ndërsjellë dhe miqësinë midis dy vendeve,

kanë rënë dakord për Programin e mëposhtëm të bashkëpunimit, për vitet 2022–2025.

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. Arsimi

1.1 Palët do të promovojnë shkëmbimin e informacionit dhe të kontakteve konstruktive midis dy vendeve, në aspekte të ndryshme të arsimit.

1.2 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis instituteve arsimore të të dyja vendeve.

1.3 Palët, në përputhje me mjetet e tyre buxhetore, do të promovojnë shkëmbimin e informacionit, përvojës, dokumentacionit dhe ekspertëve në fushat e mëposhtme:

- sistemi arsimor i të dyja vendeve;
- trajnimi fillestar dhe në punë i mësuesve;
- organizimi dhe menaxhimi i shkollës;

- rregulloret për arsimin;
- edukimi për studentët me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta;
- decentralizimi dhe vetëmenaxhimi i shkollës;
- edukimi qytetar dhe edukimi për barazinë gjinore;
- arsimit për fëmijë të talentuar;
- integrimi kulturor i grupeve të pakicave (përfshirë projektet e përbashkëta);
- programet antidrogë (përfshirë projektet e përbashkëta);
- mësimdhënia e gjuhëve të huaja;
- arsimit zyrtar dhe informal;
- të mësuarit ndërdisiplinor (d.m.th. letërsia, kinemaja dhe të tjera);
- arsimit gjithëpërfshirës;
- kultura dhe trashëgimia;
- arsimit i të rriturve (të mësuarit gjatë gjithë jetës);
- edukimi shkencor dhe teknologjik;
- kontributi i të rinjve në komunitet;
- zhvillimi i aftësive jetësore;
- edukimi artistik;
- arsimit dhe formimi profesional;
- teknologjitë dhe industria e inovacionit për shkollat, mësuesit dhe studentët;
- edukimi dhe kërkimi për holokaustin.

1.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis shkollave për projekte të ndryshme të bazuara në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

1.5 Të dyja Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e mësimit *online*, përfshirë projektimin, programimin dhe zbatimin e softuerit, harduerit dhe praktikës profesionale, si: libra digjitale, softuerë menaxhimi mësimor, mjedise të mësimit në distancë, trajnim i mësuesve etj.

1.5.1 Palët do të promovojnë shkëmbimin ndërmjet institucioneve të AFP-së për aspekte të disenjimit dhe të përditësimit të ofertës së arsimit dhe formimit profesional.

1.5.2 Palët do të promovojnë shkëmbimin e botimeve, literaturës mësimore dhe informacioneve të tjera në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

1.5.3 Palët do të mundësojnë pjesëmarrjen e mësimdhënësve/nxënësve apo ekspertëve të arsimit dhe formimit profesional në konferenca/seminare/panaie aftësish kombëtare/ndërkombëtare dhe evente të tjera të ngjashme që do të mbahen në të dyja vendet, për një periudhë deri në 5 (pesë) ditë secili.

1.5.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional, stafeve mësimdhënëse dhe drejtuese dhe institucioneve të tjera të arsimit dhe formimit profesional.

1.5.5 Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e ndërsjellë të stafeve mësimdhënëse dhe nxënësve në arsimin profesional, me qëllimin e ekspozimit me metoda inovative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe me të rejtat e teknikës dhe teknologjisë në fushat respektive profesionale. Kushtet dhe rregullat e këtyre shkëmbimeve do të dakordësohen nga institucionet përkatëse ose me anë të kanaleve diplomatike, sipas rastit.

1.6 Palët do të inkurajojnë zhvillimin e partneriteteve shkollore, veçanërisht në fushat e matematikës dhe teknologjisë. Partneritetet mund të hartohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme, të tilla si: projekte të përbashkëta virtuale, programe binjakëzimi shkollorë, shkëmbim delegacionesh dhe vizita të ndërsjella të mësuesve dhe të nxënësve nga shkollat përkatëse.

1.7 Të dyja palët do të inkurajojnë shkëmbimet dhe bashkëpunimin në fushën e krijimtarisë dhe të inovacionit, për të kultivuar sensin e inovacionit dhe të kreativitetit midis mësuesve dhe studentëve.

Në Izrael, informacioni mbi sistemin arsimor mund të merret nga faqja e internetit e Ministrisë së Arsimit: www.education.gov.il.

Në Republikën e Shqipërisë, informacioni mbi sistemin arsimor mund të merret nga faqja e internetit: www.arsimi.gov.al.

1.8 Palët do të vepronë për të promovuar mësimin e gjuhës, letërsisë, historisë dhe kulturës së vendit tjetër në institucionet e tyre përkatëse të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë. Për këtë qëllim, ekspertët përkatës nga vendi partner do të ftohen të mbajnë leksione, seminare dhe të zhvillojnë veprimtari të tjera arsimore. Kushtet në të cilat ekspertët do të kryejnë veprimtaritë e tyre përkatëse në vendin pritës do të negociohen midis institucioneve të tyre përkatëse të të dyja vendeve ose me anë të kanalit diplomatik.

1.9 Palët janë të angazhuara për të parandaluar botimin e librave shkollorë, që nxisin racizmin, antisemitizmin dhe ksenofobinë, në mënyrë që të kundërshtojnë paragjykimet dhe stereotipat negativë. Secila palë do të njoftojë palën tjetër nëse zbulohen botime të tilla.

1.10 Palët do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë punës kërkimore dhe edukative, në lidhje me fatin e komunitetit hebre të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore nën sundimin nazist.

Pala shqiptare do të vazhdojë të përfshijë çështjen e holokaustit në kurrikulën shkollore. Pala shqiptare kërkon të përmirësojë punën e saj për të trajnuar mësues dhe hartues të kurrikulës në fushën e edukimit dhe të përkujtimit të holokaustit, me mbështetjen profesionale të Palës izraelite, siç përshkruhet në një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet *Yad Vashem*-it – Qendra Botërore e Përkujtimit të Holokaustit në Jerusalem dhe e Ministrisë Shqiptare të Arsimit dhe Sportit, në datën 21 dhjetor 2015.

Palët do të synojnë të rinovojnë memorandumun e vitit 2015.

1.11 Palët theksojnë rëndësinë e inkurajimit të arsimtarëve dhe të rinjve për të mësuar rreth holokaustit gjatë shkollimit, duke iu referuar, gjithashtu, përmbajtjes së Deklaratës së Stokholmit të janarit 2000 dhe rezolutës së Kombeve të Bashkuara 60/7, të 1 nëntorit 2005, që cakton datën 27 Janar, si Ditën Ndërkombëtare Përkujtimore, në kujtim të viktimave të holokaustit, e cila thekson karakterin unik historik të holokaustit dhe denoncon rreziqet ende ekzistuese të gjenocidit, racizmit, antisemitizmit dhe ksenofobisë. Në këtë kontekst, palët do të mbështesin aktivitetet arsimore të ndërmarra në shkolla të të gjitha niveleve, që synojnë luftën kundër racizmit dhe antisemitizmit. Pala izraelite njeh interesin e Shqipërisë për t'u lidhur më ngushtë me Aleancën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, një organ qeveritar ndërkombëtar me më shumë se 30 qeveri, si vende anëtare deri më sot.

1.12 Palët do të inkurajojnë pjesëmarrjen e mësuesve dhe veçanërisht të mësuesve të historisë, në seminarët e zhvillimit profesional mbi edukimin e holokaustit, duke theksuar fuqimisht mjetet dhe antisemitizmin, teknika për zbatim në klasë. Këto seminare, që synojnë krijimin e rrjeteve të qëndrueshme të instituteve të shumta arsimore, organizohen nga Departamenti Evropian i Shkollës Ndërkombëtare për Studime të Holokaustit të *Yad Vashem*-it, Qendra Botërore e Përkujtimit të Holokaustit në Jerusalem. Këto aktivitete të zhvillimit profesional mund të organizohen si në Shqipëri edhe në Izrael.

1.13 Palët do të inkurajojnë pjesëmarrjen e studiuesve në aktivitetet akademike të organizuara nga Instituti Ndërkombëtar i Kërkimit të Holokaustit të *Yad Vashem*-it dhe do të kërkojnë bashkëpunim akademik, që synon zgjerimin e dokumentacionit ekzistues dhe kërkimit rreth holokaustit në Shqipëri.

1.14 Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e kopjeve të dokumenteve nga periudha e holokaustit, para luftës dhe pas luftës, ose marrjen e tyre dhe do të lejojnë që arkivat e *Yad Vashem*-it të lokalizojnë, skanojnë dhe kopjojnë të gjithë materialin arkivor në Shqipëri nga periudha e holokaustit, para luftës dhe pas luftës, në mënyrë që të lejojë studiuesit, arsimtarët dhe publikun të kenë akses te këto materiale, siç përshkruhet në Marrëveshjen për Bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe *Yad Vashem*-it të Autoritetit për Përkujtimin e Dëshmorëve dhe Heronjve të Holokaustit në fushën e Arkivave, të nënshkruar në Jerusalem, më 30 tetor 2016.

2. Bursat

2.1 Pala izraelite, në varësi të burimeve të disponueshme, do të ofrojë çdo vit 1 (një) bursë për kurs veror të gjuhës hebraike moderne dhe 2 (dy) bursa specializimi, për 1 (një) vit akademik (tetë muaj) secili, për studentët pasuniversitarë ose kërkuesit që dëshirojnë të ndërmarrin studime në një nga programet e institucioneve të arsimit të lartë në Izrael, të njohura nga Këshilli i Arsimit të Lartë.

Informacioni për aplikantët (data e mbylljes për paraqitjen e aplikimeve, kufiri i moshës, dokumentet e nevojshme, formularët e aplikimit, detajet mbi përfitimet e grantit etj.) do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme: <http://www.mfa.gov.il> dhe do të publikohet çdo vit me anë të kanaleve diplomatike.

2.2 Pala shqiptare, në varësi të burimeve të disponueshme, do të ofrojë çdo vit 1 (një) kurs veror të gjuhës shqipe dhe 2 (dy) bursa për programe studimi për 1 (një) vit akademik (tetë muaj) secili, për studentët/kërkuesit izraelitë të ciklit të dytë ose të tretë të studimeve që dëshirojnë të ndërmarrin studime në një institucion të arsimit të lartë në Shqipëri.

2.3 Këto bursa u nënshtrohen kuadrove buxhetore të palëve.

3. Bashkëpunimi ndërmjet institucionit/institucioneve të arsimit të lartë

3.1 Pa cenuar autoritetin e Këshillit për Arsimin e Lartë (KAL) në fushën e arsimit të lartë dhe autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, palët do të bashkëpunojnë, si më poshtë:

3.2 Palët do të promovojnë shkëmbimin e botimeve, literaturës, materialeve kërkimore dhe informacioneve të tjera në fushën e arsimit të lartë.

3.3 Palët do të mundësojnë pjesëmarrjen e 3 (tre) akademikëve në konferenca/seminare kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe evente të tjera të ngjashme që do të mbahen në të dyja vendet, për një periudhë deri në 5 (pesë) ditë secili, ndërsa ky Program është në fuqi.

3.4 Palët do të bashkëpunojnë në promovimin e studimeve, në lidhje me kulturat, gjuhët dhe historinë moderne të vendit të njëra-tjetrës në institutet/institucionet përkatëse të arsimit të lartë.

4. Shkenca

4.1 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve shkencore dhe kërkimore. Përmbajtja e këtij bashkëpunimi do të dakordësohet nga institucionet kompetente të të dyja vendeve.

4.2 Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e ndërsjellë të punonjësve shkencorë dhe kërkimorë, me qëllimin e kërkimit, studimeve, konsultimeve dhe diskutimeve në disiplinat shkencore. Kushtet dhe rregullat e këtyre shkëmbimeve do të dakordësohen nga institucionet përkatëse dhe/ose me anë të kanaleve diplomatike, sipas rastit.

4.3 Palët do të inkurajojnë kërkime të përbashkëta shkencore dhe teknologjike, kërkime dhe projekte zhvillimi në fusha me interes të përbashkët, si dhe shkëmbimin e informacionit shkencor dhe teknik, dhe botimeve.

4.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve të arsimit të lartë, akademive të shkencave dhe institucioneve të tjera kërkimore shkencore.

5. Shkëmbimi i ekspertëve të kulturës dhe të artit

Pasqyrë e përgjithshme

Palët mirëpresin nivelin e lartë të aktiviteteve kulturore të ndërsjella, duke theksuar rolin e vlefshëm të luajtur nga lidhjet kulturore midis dy vendeve. Palët rikonfirmojnë synimet e tyre për të vazhduar të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve kulturore, organizatave dhe individëve në të dyja vendet.

Palët do të inkurajojnë iniciativa të krijuara për të ndihmuar organizatat publike dhe private, dhe individët e angazhuar në promovimin dhe sponsorizimin e aktiviteteve kulturore me origjinë izraelite në Shqipëri dhe aktiviteteve kulturore me origjinë shqiptare në Izrael.

5.1 Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e muzikës, teatrit, arteve pamore dhe plastike, dizajnit, vallëzimit dhe të gjitha grupeve të tjera artistike ose individëve, që marrin pjesë në turne, festivale dhe evente të tjera kulturore, duke përfshirë konferenca, simpoziume, shfaqje të ndërsjella, punëtori, ekspozime artistike dhe takime që përfshijnë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave. Gjithashtu, palët do të inkurajojnë vizitat e kritikëve të artit, interpretuesve,

studiuesve, shkrimtarëve dhe gazetarëve që merren me kulturë, me synimin për të promovuar një perceptim më të mirë të zhvillimeve sociologjike dhe kulturore që ndodhin në vendin tjetër.

5.2 Festivale të arteve performuese

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e ekspertëve dhe artistëve për shfaqje dhe pjesëmarrje në festivalet e tyre të artit skenik. Detajet në lidhje me këto shkëmbime, të tilla si numri i artistëve dhe kohëzgjatja e qëndrimit, do të bazohen në parimet e reciprocitetit dhe do të bien dakord nga Palët dhe/ose institucionet përkatëse, sipas rastit.

Palët do të informojnë njëra-tjetrën paraprakisht me anë të kanaleve diplomatike për festivale të mëdha ndërkombëtare që do të mbahen në vendet e tyre përkatëse, në mënyrë që të lehtësojnë një pjesëmarrje të tillë. Informacioni, gjithashtu, do të publikohet në faqet e internetit të autoriteteve përkatëse kompetente dhe institucioneve.

5.3 Artet pamore, fotografia dhe dizajni

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e arteve figurative, panairëve të artizanatit, fotografisë dhe dizajnit. Ato do të inkurajojnë shkëmbimin e ekspozitave dhe bashkëpunimin midis artistëve, zejtarëve popullorë, ekspertëve të artit dhe specialistëve në veprat tradicionale popullore.

5.4 Arkitektura

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis arkitektëve, institucioneve arkitektonike dhe shkëmbimin e arkitektëve, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe promovimin e ekspozitave.

5.5 Muzetë dhe ekspozitat

Palët do të inkurajojnë kontakte të drejtpërdrejta midis muzeve, galerive dhe institucioneve të ngjashme në të dyja vendet, duke përfshirë shkëmbimin e specialistëve, kuratorëve, materialeve, ekspozitave speciale dhe informacionit.

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e ekspozitave të artit bashkëkohor, duke përfshirë vepra arti nga muzetë, hapësirat zyrtare dhe ekspozitave alternative, galeri private, shkolla dhe galeri të trajnimit të artistëve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta të arteve bashkëkohore.

5.6 Muzika:

Palët do të inkurajojnë prezantimin e punës së kompozitorëve të tyre në vendin tjetër. Ato, gjithashtu, do të mbështesin kontakte të drejtpërdrejta midis muzikantëve (dirigjentë, solistë etj.), organizatave muzikore, institucioneve, shoqatave, orkestrave dhe konservatorëve në fushat e muzikës klasike dhe bashkëkohore, duke përfshirë shkëmbimin e regjistrimeve dhe vizitat personale mbi baza tregtare dhe jotregtare.

Palët do të përpiqen të lehtësojnë pjesëmarrjen e muzikantëve të tyre, si dhe anëtarëve të jurive dhe vëzhguesve në festivale, konkurse dhe evente të mëdha të organizuara në të dyja vendet.

5.7 Kërcimi

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e valltarëve, koreografëve, ekspertëve të vallëzimit, mësuesve dhe producentëve të festivaleve të vallëzimit. Palët, gjithashtu, do të marrin pjesë së bashku në zhvillimin e bashkëpunimit kulturor shumëpalësh.

5.8 Teatri

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e aktorëve, regjisorëve, dramaturgëve, kritikëve etj. Palët, gjithashtu, do të marrin pjesë së bashku në zhvillimin e bashkëpunimit kulturor shumëpalësh.

5.9 Palët do të mundësojnë vizita vjetore të ekspertëve/artistëve/prodhuesve/kuratorëve në fushat e ndryshme të lartpërmendura të arteve, për një periudhë totale jo më shumë se 5 (pesë) ditë çdo vit. Projektet do të dakordësohen nga Palët me anë të kanaleve diplomatike.

6. Trashëgimia kulturore dhe arkeologjia

6.1 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke shkëmbyer informacion, në lidhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse kombëtare. Gjithashtu, ato do të inkurajojnë aktivitete që synojnë ruajtjen e vendeve me interes të përbashkët.

6.2 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Ato, gjithashtu, do të shkëmbejnë

profesionistë, ekspertë akademikë, informacione dhe materiale publicitare, si dhe informacione mbi seminare.

6.3 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis institucioneve kombëtare përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, menaxhimin dhe promovimin e vendeve kombëtare të përshkruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

6.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e gërmimeve arkeologjike, konservimit urban dhe hulumtimeve të arkitekturës. Detajet e këtij bashkëpunimi do të dakordësohen nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve.

6.5 Palët do të inkurajojnë autoritetet përkatëse, në vendet e tyre përkatëse, për të shkëmbyer informacione dhe botime me përmbajtje arkeologjike. Ato, gjithashtu, do të nxisin organizimin e seminareve të përbashkëta për tema me interes të ndërsjellë që do të mbahen gjatë këtij Programi. Detajet në lidhje me këtë do të përcaktohen nga Autoriteti i Antikiteteve të Izraelit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike.

6.6 Gjatë këtij Programi Palët do të shkëmbejnë 1 (një) ekspert çdo vit nga fushat e arkeologjisë, ruajtjes së antikave, restaurimit të trashëgimisë kulturore ose konservimit të monumenteve dhe arkitekturës, për një periudhë deri në 5 (pesë) ditë. Detajet në lidhje me këtë do të përcaktohen nga Autoriteti i Antikiteteve të Izraelit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike.

6.7 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në fushën e ruajtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore hebraike. Detajet e këtij bashkëpunimi do të bien dakord nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve.

6.8 Palët do të inkurajojnë autoritetet përkatëse në vendet e tyre përkatëse për të shkëmbyer informacione dhe botime në lidhje me trashëgiminë kulturore hebraike. Ato, gjithashtu, do të inkurajojnë organizimin e seminareve të përbashkëta të lëndëve me interes të ndërsjellë që do të mbahen gjatë këtij Programi. Detajet në lidhje me këtë do të përcaktohen nga Autoriteti i Antikiteteve të Izraelit dhe autoritetet e tjera përkatëse dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë.

7. Letërsia dhe panairët e librit

7.1 Palët do të punojnë së bashku për të promovuar përkthimin e prozës bashkëkohore, poezisë dhe veprave të tjera letrare të vendit të tyre në gjuhët e Palës tjetër. Palët, gjithashtu, do të inkurajojnë shpërndarjen e këtyre veprave të përkthyer.

Për këtë qëllim, Palët do të shkëmbejnë çdo vit 3 (tre) persona (shkrimtarë, poetë ose përkthyes) secili për një qëndrim deri në 5 (pesë) ditë, ndërsa ky Program është në fuqi.

7.2 Palët do të inkurajojnë shkrimtarët dhe redaktorët që të marrin pjesë në seminare, takime dhe lexime poetike, që synojnë promovimin e njohjes më të gjerë midis dy komuniteteve letrare. Palët do të mbështesin pjesëmarrjen e poetëve dhe shkrimtarëve në festivale dhe evente letrare deri në 5 (pesë) ditë në vit.

7.3 Palët do të inkurajojnë kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet botuesve të librave dhe bibliotekave kombëtare.

7.4 Secila palë do të ftojë palën tjetër të marrë pjesë në panairët e tyre përkatëse ndërkombëtare të librit mbi baza tregtare dhe jotregtare, për aq kohë që ky Program është në fuqi.

Pala shqiptare fton Palën izraelite të marrë pjesë në një nga panairët ndërkombëtare shqiptare të librit, i cili do të mbahet në Tiranë. Informacioni në lidhje me këtë panair mund të gjendet në: www.kultura.gov.al.

8. Kinemaja dhe fusha audiovizuale

8.1 Palët do të inkurajojnë pjesëmarrjen e filmave dhe të krijuesve të filmave në festivalet ndërkombëtare të filmit të njëra-tjetër. Palët do të promovojnë retrospektiva të veçanta të kinemasë të vendit tjetër si pjesë e festivaleve ndërkombëtare të filmit që mbahen në vendin e tyre. Informacioni në lidhje me festivalet kryesore të filmit do të shkëmbehet me anë të kanaleve diplomatike.

8.2 Palët do të inkurajojnë mbajtjen e javëve të filmit të Palës tjetër në vendin e tyre. Filmat që shfaqen në këtë kuadër do të kenë titra në anglisht, nëse gjuha e filmit nuk është në gjuhën angleze.

8.3 Secila palë do të inkurajojë vizitat e ndërsjella të një eksperti ose figure publike në fushën e kinemasë. Për këtë qëllim, palët do të shkëmbejnë çdo vit 2 (dy) ekspertë, secili në fushat e kinemasë dhe audiovizuale për një periudhë deri në 5 (pesë) ditë për të marrë pjesë në festivale, konferenca, vlerësime, takime, retrospektiva dhe evente të tjera prestigjioze ndërkombëtare.

8.4 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis ekspertëve të kinemasë dhe të televizionit, si dhe instituteve të filmit dhe të televizionit.

Palët mirëpresin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis shkollave të filmit dhe televizionit, si dhe midis kinemave të tyre kombëtare dhe shkëmbimin e studentëve dhe të mësuesve në këtë fushë.

8.5 Palët shprehin interesin e tyre për të promovuar bashkëprodhime midis producentëve shqiptarë dhe izraelitë të filmit. Palët do të diskutojnë dhe do të arrijnë një marrëveshje të bashkëprodhimit (të filmave dhe videove), me qëllim mundësimin e bashkëprodhimeve të ardhshme të filmit.

8.6 Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin midis autoriteteve televizive në të dyja vendet, si dhe shkëmbimin e materialeve (film me metrazh të gjatë dhe dokumentar) dhe ekspertëve në këtë fushë, mbi baza tregtare dhe jotregtare. Gjithashtu, palët do të inkurajojnë organizimin e takimeve mbi edukimin përmes televizionit, trajnimin e stafit dhe sigurimin e materialit paraprak, që synon rritjen e njohurive dhe njohjen reciproke të vendeve.

8.7 Palët do të promovojnë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës së regjisorëve të filmit në fushën e menaxhimit të sektorit audiovizual, në kushtet e tranzicionit digjital dhe dominimit të internetit.

8.8 Palët do të vazhdojnë të bashkëpunojnë midis institucioneve publike audiovizuale (Qendra Kombëtare Shqiptare e Kinematografisë, Arkivi Kombëtar i Filmit dhe institucione të tjera) për sa i përket performancës në panairët dhe festivalet e vendeve të treta, si dhe për digjitalizimin, ruajtjen dhe shkëmbimin reciprok të arkivave të filmit.

8.9 Palët do të inkurajojnë shfaqjet nga autorët dhe prezantimin e titujve audiovizualë të vendeve të tjera në festivale të organizuara në vendin e tyre, duke përfshirë punimet më të mira të Palës tjetër në programet e tyre kombëtare të zhvillimit të audiencës dhe të edukimit të brezit të ri, në lidhje me shkrimin dhe kulturën audiovizuale.

9. Arkivat dhe bibliotekat

9.1 Palët do të promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë midis departamenteve të arkivit të institucioneve shtetërore dhe publike dhe bibliotekave, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës, nëpërmjet shkëmbimeve të ekspertëve, botimeve shkencore, mikrofilmave, librave, informacionit digjital, kopjeve të dokumenteve, bazave të të dhënave dhe rregulloreve. Shkëmbimet do të kryhen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme të secilit vend dhe do t'u nënshtrohen kuadrove buxhetore të Palëve.

9.2 Palët do të konsiderojnë shkëmbimin e 1 (një) arkivisti ose bibliotekari për një periudhë pesëditore (5-ditore) gjatë periudhës së këtij Programi, në mënyrë që të marrin informacione mbi organizimin e arkivave/bibliotekave përkatëse, si dhe misionet studimore dhe kërkimore.

10. Bashkëpunimi në kuadër të organizatave ndërkombëtare

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, rinisë dhe komunikimit, në kuadrin e organizatave ndërkombëtare, të tilla si Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të veprimit.

11. Shkëmbimi i të rinjve

11.1 Palët bien dakord që shkëmbimi i të rinjve dhe i të rriturve të rinj përbëjnë një kontribut madhor në marrëdhëniet midis dy vendeve. Si rrjedhojë, ato do të mbështesin programe të tilla.

Theksi do të vendoset në pjesëmarrjen aktive të të rinjve në komunitet dhe promovimin e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të të rinjve përmes aktiviteteve specifike rinore.

11.2 Palët do të inkurajojnë projekte të ndërsjella të profesionistëve dhe të ekspertëve në fushën e të rinjve. Detajet në lidhje me këtë do të përcaktohen midis Autoritetit të Shkëmbimit Rinor të Izraelit dhe Agjencisë Kombëtare për Rininë në Shqipëri.

11.3 Palët do të lehtësojnë bashkëpunimin midis të rinjve në vendet e tyre nëpërmjet shkëmbimit të delegacioneve të ekspertëve qeveritarë në fushën e të rinjve dhe përfaqësuesve të organizatave rinore.

12. Sporti

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në sport, kryesisht duke shkëmbyer ekipe sportive, trajnerë dhe ekspertë në disiplina të ndryshme. Detajet do të përpunohen përmes konsultimeve të ndërsjella ndërmjet organizatave të interesuara të të dyja vendeve. Këto organizata do të bien dakord mbi termat dhe kushtet e këtyre shkëmbimeve.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

13. Pronësia intelektuale

13.1 Secila palë do të sigurojë mjete ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale të të gjitha materialeve të përfuara në kuadrin e këtij Programi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendin e saj.

13.2 Të drejtat e pronësisë intelektuale, të fituara ose të krijuara si rezultat i veprimtarisë së përbashkët, në përputhje me këtë Program, do të caktohen me kushte të rëna dakord reciprokisht, të përcaktuara në masa të ndara para fillimit të aktivitetit të përbashkët.

13.3 Asnjë palë nuk do t'i transmetojë informacion konfidencial të vlefshëm të marrë në zbatim të këtij Programi ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës nga e cila ka origjinën një informacion i tillë.

14. Dispozitat financiare

14.1 Dispozitat financiare dhe të tjera, si dhe skedulet e eventeve do të dakordësohen me konsultime të ndërsjella midis autoriteteve përkatëse të të dyja vendeve. Në rast të ndonjë rregullimi të veçantë, dispozitat financiare do të rregullohen në bazë të reciprocitetit, specifikisht:

- Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimeve ndërkombëtare të delegacioneve dhe përfaqësuesve të tyre;

- Palë pritëse do të mbulojë shpenzimet e akomodimit në vendin e saj.

14.2 Shkëmbimi i individëve (artistë, ekspertë etj.): Shkëmbimi do të rregullohet si më poshtë:

- Personat ose delegacionet e ftuara duhet të jenë të aftë të komunikojnë në gjuhën e vendit ose institucionit pritës ose në anglisht, ose në ndonjë gjuhë tjetër për të cilën është rënë dakord reciprokisht.

- Secili individ dhe delegacion do të jetë përgjegjës për sigurimin e tij mjekësor.

14.3 Bursat

Termet dhe kushtet e bursave të specializimit të dhëna nga ana e Izraelit për një vit akademik do të publikohen çdo vit me anë të kanaleve qeveritare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë Izraelite të Punëve të Jashtme: <http://www.mfa.gov.il>.

Pala izraelite do t'u sigurojë pjesëmarrësve shqiptarë në Kursin Veror të Shkollës së Gjuhës ULPAN/përfituesit e bursave të pranuar në këtë Program, sa më poshtë:

a) tarifë shkollimi falas;

b) kompensim për shpenzimet e jetesës, në përputhje me kushtet e shkollës/institucioneve akademike të gjuhës;

c) sigurim shëndetësor, me përjashtim të kujdesit dentar dhe sëmundjeve kronike.

Pala shqiptare do t'u sigurojë pjesëmarrësve izraelitë në kursin veror shqiptar të organizuar nga Universiteti i Tiranës/përfituesit e bursave akademike, në përputhje me këtë Program, sa më poshtë:

a) shkollim falas;

b) kompensim për shpenzimet e jetesës në përputhje me legjislacionin kombëtar;

c) sigurim shëndetësor, me përjashtim të kujdesit dentar dhe sëmundjeve kronike.

14.4 Shkëmbimi i ekspozitave: Dispozitat financiare për secilin projekt do të dakordësohen veçmas midis palëve.

15. Dispozitat përfundimtare

15.1 Ky Program nuk përjashton realizimin e shkëmbimeve të tjera në fushat kulturore, shkencore dhe arsimore.

15.2 Palët bien dakord që të gjitha iniciativat e përmendura në këtë Program do të kryhen brenda kufijve të fondeve të alokuara në buxhetet e tyre përkatëse vjetore.

15.3 Çdo aktivitet i kryer nga një Palë, në përputhje me këtë Program, do të realizohet në përputhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat e saj kombëtare.

Ky Program nuk është ligjërishit i detyrueshëm dhe nuk krijon ndonjë të drejtë ose detyrim për palët sipas së drejtës ndërkombëtare.

15.4 Të gjitha ndryshimet që mund të lindin gjatë këtij Programi do të zgjidhen me mirëkuptim, me anë të kanaleve diplomatike.

15.5 Palët ngarkojnë autoritetet e tyre kompetente, në lidhje me zbatimin e këtij Programi.

15.6 Ky Program mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet do të bëhen me shkrim.

15.7 Ky Program do të hyjë në fuqi ditën e njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike që deklarohen se Palët kanë përfunduar procedurat e tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e tij në fuqi. Ai do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2025. Ai do të zgjatet automatikisht për një periudhë shtesë prej 3 (tre) vjetësh, përveç nëse ndonjë nga palët njofton palën tjetër nëpërmjet një note diplomatike, për qëllimin për ta ndërprerë atë, të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë para datës së përfundimit të tij të synuar.

15.8 Përfundimi i këtij Programi nuk do të ndikojë në aktivitetet e vazhdueshme për të cilat është rënë dakord para përfundimit të tij.

Nënshkruar _____, më _____, të _____ 2022, të _____, që korrespondon me _____, ditën e _____, 5782_, në kalendarin hebraik, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E SHTETIT TË
IZRAELIT